



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
SENATI AKADEMIK

VENDIM

Nr. 33, datë 11.11.2019

PËR

“RIALOKIMIN E KUOTAVE TË PRANIMIT TË STUDENTËVE TË CIKLIT TË DYTË TË STUDIMEVE ME KOHË TË PLOTË MASTER, PËR VITIN AKADEMIK 2019-2020, NË UNIVERSITETIN E ARTEVE”

Në zbatim të nenit 38 funksionet e Senati Akademik, pika 3 dhe Nenit 69 e në vijim të Ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, nisur nga kërkesat e Dekanëve: të Fakultetit të Muzikës me Nr. 322 Prot., datë 08.10.2019; të Fakultetit të Artit Skenik me Nr. 459 Prot., datë 23.10.2019 dhe Të Fakultetit të Arteve të Bukura me Nr. 106 Prot., datë 28.10.2019 mbi rialokimin e kuotave të miratuara nga Senati Akademik me VSA Nr. 15, datë 09.04.2019, VSA Nr. 16, datë 09.04.2019 dhe VSA Nr. 17, datë 09.04.2019 të Universitetit të Arteve, Senati Akademik pasi diskutoi mbi “Kërkesat e fakulteteve mbi rialokim të kuotave të miratuara të ciklit të dytë të studimeve me kohë të plotë Master për vitin akademik 2019-2020, në Universitetin e Arteve”.

V E N D O S I:

1. Rialokimin e kuotave të pranimit të studentëve të ciklit të dytë të studimeve me kohë të plotë Master, për vitin akademik 2019-2020, në Universitetin e Arteve, si më poshtë:
 - Programi i studimit Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi cikli i dytë i studimeve Master Profesional dhe Mësuesi **10 (dhjetë)** kuota. Më konkretisht merren nga: 1 kuotë nga Kosova, 1 kuotë nga Maqedonia e Veriut, 1 kuotë nga Mali i Zi, 1 kuotë nga kandidatë me statusin e personit të kufizuar, 1 kuotë nga kandidatë Rom dhe Egjiptian si dhe 5 kuota nga kandidatë që aplikojnë për program të dytë studimi.
 - Programi i studimit Regji Teatri dhe Spektakli dhe Mësuesi cikli i dytë i studimeve Master i Arteve **2 (dy)** kuota. Më konkretisht merren nga: 1 kuotë nga Kosova dhe 1 kuotë nga Maqedonia e Veriut.
 - Programi i studimit Regji Filmi dhe TV dhe Mësuesi cikli i dytë i studimeve Master i Arteve **1 (një)** kuotë. Më konkretisht merret nga: 1 kuotë nga Kosova.
 - Programi i studimit Koreografi dhe Mësuesi cikli i dytë i studimeve Master i Arteve **1 (një)** kuotë. Më konkretisht merret nga: 1 kuotë nga Maqedonia e Veriut.
 - Programi i studimit Pikturë Kavaleti dhe Mësuesi cikli i dytë i studimeve Master i Arteve **2 (dy)** kuota. Më konkretisht merren nga: 1 kuotë nga kandidatë me statusin e personit të kufizuar, 1 kuotë nga kandidatë Rom dhe Egjiptian.
 - Programi i studimit Pikturë Tekstil & Modë dhe Mësuesi cikli i dytë i studimeve Master i Arteve **2 (dy)** kuota. Më konkretisht merren nga: 1 kuotë nga kandidatë me statusin e personit të kufizuar, 1 kuotë nga kandidatë Rom dhe Egjiptian.

